



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“BUJQËSI”

Niveli II në KSHK¹, referuar nivelit II të KEK²

H-II-22

Tiranë, 2022

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“Bujqësi”		Kodi H-II-22
Kohëzgjatja	1900-2100 orë	Niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional në drejtimin mësimor “Bujqësi” niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, është të përgatisë punonjës me kualifikim bazë për bujqësinë, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.		
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në drejtimin mësimor “Bujqësi” niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, kanë të drejtë të hyjnë të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> – kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; – janë në kushte shëndetësore që e lejojnë përballimin e kërkesave të këtij niveli të kualifikimit profesional. <p>Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitet reale të këtyre shkollave, atëherë institucionet përgjegjëse përgatit udhëzime të veçanta për pranimin në këto shkolla.</p>		
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin mësimor “Bujqësi”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të nivelit të punonjësit gjysmë të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim profesional.</p> <p>Ky arsimim profesional i jep individit mundësi t'i drejtohet tregut të punës si punonjës gjysmë i kualifikuar në ndërmarrje/ferma konvencionale dhe organike bujqësore dhe blegtorale, në kopshtari, në parqe, në agroturizëm, në sera, në fidanishte, në pemëtari, vreshtari, ferma të ullishtave, në fermat e mbarështimit të gjedhëve, dhënëve dhe dhive, derrave dhe shpendëve, kultivimit të bletëve, peshqve e specieve të tjera me interes ekonomik, në zooparqe apo në parqet natyrore, në klinikat veterinare ose veprimtari të tjera që veprojnë në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë. Gjithashtu, individit mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual ose familjar në fushën e prodhimeve bujqësore.</p> <p>Për sa i përket arsimimit të mëtejshëm, individit ka mundësi të vazhdojë studimet në nivelin III të KSHK, referuar nivelit III të KEK, në një prej profileve të drejtimit mësimor “Bujqësi”. Me vijimin e mëtejshëm të arsimit profesional në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individit fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>		
Data e validimit			
Data e miratimit			
Variantet e mëparshme	H-I-11; H-II-16		

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit në profesionin “Bujqësi” niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale, të ndara sipas fushave, të mëposhtme:

Bazat e bujqësisë

- Të përshkruajë rëndësinë social ekonomike dhe mjedisore të bujqësisë për vendin tonë;
- Të përshkruajë ndryshimet midis Ekosistemit dhe Agroekosistemit, qarkullimin e lëndëve në ekosistem;
- Të listojë disa nga veprimtaritë e njeriut dhe ndikimet mbi ekuilibrin e ekosistemit;
- Të përshkruajë atmosferën, elementët përbërës, ndikimi i dukurive atmosferike mbi rritjen dhe zhvillimin e bimëve bujqësore;
- Të përshkruajë zonat dhe nënzonat klimatike të vendit tonë dhe bimësinë përkatëse të tyre;
- Të përshkruajë llojet e bimëve bujqësore dhe klasifikimin i tyre;
- Të përshkruajë morfologjinë e bimëve;
- Të rendisë proceset fiziologjike dhe roli i tyre në jetën e bimëve;
- Të listojë rregullatorët e rritjes dhe rëndësinë e tyre në bimë;
- Të përshkruajë konceptin e “rritjes dhe zhvillimit” të bimëve, si dhe fazat përkatëse të tyre;
- Të përshkruajë shumëzimin me farë dhe shtimin në mënyrë vegjetative të bimëve bujqësore, si dhe faktorët që ndikojnë mbi to;
- Të përshkruajë përbërësit organike dhe inorganike të tokës, si dhe ndikimi i tyre në jetën e bimës;
- Të përshkruajë tretësirën dhe reaksionin e tokës (Ph), ndikimet mbi jetën e bimës;
- Të përshkruajë elementët kryesorë që përcaktojnë cilësitë fizike dhe mekanike të tokës;
- Të interpretojë fenomenin e erozionit të tokës, faktorët që e shkaktojnë dhe masat mbrojtëse kundër tij;
- Të përshkruajë faktorët që shkaktojnë përmytjet dhe ndikimet e tyre në jetën dhe zhvillimin e bimëve;
- Të listojë disa nga elementët e domosdoshmërisë së përdorimit të ujitjes në kultivimin e bimëve bujqësore;
- Të përshkruajë konceptin dhe parimet e përgjithshme të qarkullimit bujqësor dhe bashkëhoqërimit në ruajtjen e pjellorisë së tokës;
- Të shpjegojë konceptin e barërave të këqija të bimëve bujqësore dhe dëmet në prodhimin bujqësor;
- Të përshkruajë elementët kryesorë ushqyes të tokës (makro dhe mikro elementët);
- Të përshkruajë simptomat kryesore të bimëve të prekura nga sëmundjet dhe dëmtuesit;
- Të përshkruajë rëndësinë e bujqësisë organike;
- Të përshkruajë elementët bazë të Praktikave të Mira Bujqësore (GAP);
- Të përshkruajë dhe të interpretojë hidrometeorët kryesorë;
- Të përshkruajë të dhënat kryesore agro-meteorologjike si temperatura, lagështia, presioni, intensiteti dhe shpeshësia e shiut, shpejtësia e erës;
- Të përshkruajë instrumentet e zbulimit të përfshira në një qendër meteorologjike si: termometër, higrometër/barometër, matës shiu dhe pluviograf, anemometër, anemoskop,

piranograf, heliofanograf, avullometër;

Organizimi i punës dhe përgatitja e vendit të punës për kryerjen e aktiviteteve bujqësore dhe blegtorale

- Të përshkruajë rëndësinë e organizimit dhe vendosjes së mjeteve, pajisjeve dhe materialeve për procese të ndryshme pune;
- Të listojë veglat, pajisjet dhe materialet e punës që përdoren në procese të ndryshme pune në bujqësi dhe blegtori;
- Të përshkruajë rëndësinë e përgatitjes personale për punë në përputhje me rregulloret e higjienës dhe të sigurimit teknik;
- Të përshkruajë rëndësinë e përzgjedhjes dhe përgatitjes së bazës materiale për fillimin e punës sipas proceseve dhe planifikimeve të punës;
- Të përshkruajë mënyrën e pastrimit ose dezinfektimit, sistemimit të vendit dhe mjetet e punës pas çdo procesi të pune;

Përgatitja e tokës për mbjellje

- Të përshkruajë konceptin mbi tokën, tokën bujqësore, pjellorinë dhe prodhimtarinë e saj;
- Të tregojë llojet e relievit dhe përshtatshmërinë e tyre për kultivimin e kulturave bujqësore;
- Të përshkruajë tipin e tokës dhe karakteristikat e saj;
- Të listojë proceset e parapërgatitjes së tokës për mbjellje;
- Të përshkruajë rëndësinë e pastrimit të tokës nga materialet e ngurta ose mbetjet bimore;
- Të përshkruajë sistemet e kullimit dhe drenazhimit dhe rëndësinë e tyre;
- Të përshkruajë rëndësinë e përzgjedhjes së kulturave bujqësore sipas tipit të tokës;
- Të rendisë llojet e brezave mbrojtës të parcelave dhe funksionin e tyre;
- Të përshkruajë mënyrat e punimit të tokës sipas agroteknikës së kulturave bujqësore;
- Të tregojë mënyrat e marrjes së mostrës së tokës dhe përgatitjen e saj për analizë;
- Të rendisë llojet e plehërimeve të tokës dhe aplikimi i tyre sipas agroteknikës së kulturave bujqësore;
- Të përshkruajë rrjetin dhe mënyrat e ujitjes sipas agroteknikës së kulturave bujqësore;

Përgatitja e farave e fidanëve dhe mbjellja e tyre

- Të listojë llojet e farave dhe fidanëve që përdoren në bujqësi;
- Të tregojë mënyrat e ruajtjes së farave për mbjellje sipas parametrave të përcaktuar;
- Të tregojë mënyrat e ruajtjes së fidanëve për mbjellje sipas parametrave të përcaktuar;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të afateve më të përshtatshme të mbjelljes së farës dhe fidanëve;
- Të listojë llojet e trajtimeve të thjeshta profilaktike të farave dhe fidanëve para mbjelljes;
- Të rendisë llojet e farishteve dhe fidanishteve sipas kulturave, si dhe parametrat kryesore të tyre;
- Të përshkruajë llojet dhe mënyrat e shtimit të fidanëve;
- Të përshkruajë mënyrat e ndërtimit të vllajave (parcelëzë) për mbjelljen e farave dhe fidanëve;
- Të listojë format dhe mënyrat e ambalazhimit sipas llojit të kulturës bujqësore;
- Të përshkruajë rëndësinë e transportit të sigurtë të fidanëve;
- Të përshkruajë trajtimet e duhura parapërgatitore të fidanit dhe farës për mbjellje;
- Të përshkruajë teknikat e hapjes së gropave sipas parametrave teknik të kërkuar dhe llojit të kulturës bujqësore;
- Të përshkruajë distancën, thellësinë dhe teknikat e mbjelljes së farave dhe fidanëve;

- Të rendisë faktorët biotik, abiotik dhe rëndësinë e respektimit të kërkesave të farave dhe fidanëve;
- Të listojë shërbimet e duhura për mbirjen e farave dhe zënien e fidanëve;
- Të përshkruajë llojet e shërbimeve në farishte dhe fidanishte;

Shërbime të kulturave bujqësore

- Të rendisë shërbimet kryesore të kulturave bujqësore dhe afatet e kryerjes së tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e procesit të rrallimit dhe zëvendësimit të bimëve, fidanëve dhe mënyra e kryerjes së tyre;
- Të përshkruajë rëndësinë e kultivim-prashitjes së kulturave bujqësore dhe mënyrën e kryerjes së tyre;
- Të përshkruajë rëndësinë e plehërimit plotësues në kulturat bujqësore sipas fazave të zhvillimit të bimëve;
- Të përshkruajë procesin e ujitjes së kulturave bujqësore sipas kërkesave dhe fazave të zhvillimit të bimëve;
- Të tregojë-nevojën dhe mënyrën e vendosjes së sistemit mbështetës të kulturave bujqësore;
- Të përshkruajë procesin e heqjes së sjetullorëve dhe lastarëve të kulturave bujqësore;
- Të përshkruajë parimet, sistemet dhe proceset e krasitjes së kulturave bujqësore;
- Të përshkruajë procesin e rrallimit të frutave të kulturave bujqësore;
- Të listojë barërat e këqija dhe mënyrat e luftimit të tyre;

Trajtime të thjeshta profilaktike të kulturave bujqësore

- Të listojë llojet e plehërimeve organike dhe rëndësinë e përdorimit të tyre;
- Të listojë llojet e plehërimeve kimike dhe rëndësinë e përdorimit të tyre;
- Të rendisë llojet e dezinfektantëve dhe përdorimet e tyre në kulturat bujqësore sipas legjislacionit në fuqi;
- Të shpjegojë rëndësinë e sinjalizimit të specialistit përkatës për sëmundjet dhe dëmtuesit që dallohen me sy të lirë;
- Të rendisë teknikat e thjeshta për luftimin e sëmundjeve;
- Të përshkruajë teknikat e thjeshta për luftimin e dëmtuesve;

Vjelja, korrja dhe mbledhja e produkteve bujqësore dhe blegtorale

- Të listojë llojet e produkteve që prodhohen në ferma bujqësore dhe blegtorale;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e identifikimit të stadit të pjekjes së kulturave bujqësore;
- Të listojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme për vjeljen, korrjen dhe grumbullimin e produkteve bujqësore si dhe përdorimet e tyre;
- Të listojë mënyrat dhe teknikat e vjeljes, korrjes dhe mbledhjes së produkteve bujqësore;
- Të përshkruajë mënyrat e vendosjes së produkteve të vjela, në kontejner për transport të sigurt;
- Të rendisë mjetet dhe pajisjet e transportit të produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Të listojë mënyrat e pastrimit dhe seleksionimit sipas llojit të produkteve të fermës;
- Të rendisë mënyrat e grumbullimit të produkteve me origjinë shtazore dhe rëndësinë e zbatimit të sigurisë ushqimore;
- Të përshkruajë mënyrat e transportit të produkteve me origjinë shtazore;
- Të përshkruajë llojet dhe mënyrat e ambalazheve që përdoren për produktet bujqësore dhe blegtorale, të vjela;
- Të përshkruajë rëndësinë e etiketimit të produkteve sipas legjislacionit në fuqi;

- Të përshkruajë rëndësinë e njohjes dhe zbatimit të parametrave për ruajtjen e produkteve bujqësore në transport dhe në magazinë;
- Të përshkruajë disa nga elementët kryesore të dëmtueseve të produkteve bujqësore e blegtorale, pas vjeljes (myku, brejtësit, kandrrat);

Kulturat bujqësore

- Të përshkruajë rëndësinë e kultivimit të perimeve, vlerat ushqimore dhe kurative të tyre;
- Të rendisë kriteret që duhet të plotësojë ferma për ngritjen e perimores;
- Të përshkruajë rëndësinë ekonomike dhe bujqësore të serrave, grupimin e tyre sipas mënyrës së funksionimit;
- Të përshkruajë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elementë ushqyes të perimeve;
- Të përshkruajë rëndësinë e kultivimit të drithërave, si dhe vlerat ushqimore të tyre sipas llojeve;
- Të përshkruajë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elementë ushqyes të drithërave;
- Të listojë disa nga kërkesat kryesore për një prodhim të suksesshëm të kulturave të drithërave;
- Të përshkruajë rëndësinë estetike dhe mjedisore të kultivimit të bimëve zbukuruese;
- Të përshkruajë kërkesat e bimëve zbukuruese dhe luleve për kushtet klimatiko-tokësore;
- Të përshkruajë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elementë ushqyes të bimëve zbukuruese dhe luleve;
- Të përshkruajë rëndësinë ekonomike e bujqësore, vlerat ushqyese të bimëve bishtajore për kokërr;
- Të përshkruajë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elementë ushqyes të bimëve bishtajore;
- Të përshkruajë rëndësinë ekonomike e bujqësore të bimëve industriale;
- Të përshkruajë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elementë ushqyes të bimëve industriale;
- Të përshkruajë rëndësinë ekonomike dhe vlerat kurative të bimëve etero-vajore;
- Të përshkruajë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elementë ushqyes të kulturave eterovajore;
- Të përshkruajë rëndësinë ekonomiko-bujqësore të prodhimit të kulturave foragjere;
- Të rendisë veçoritë kryesore të prodhimit foragjer;
- Të përshkruajë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elementë ushqyes të prodhimit foragjer (hasëlle, tagji, kullota, livadhe, nënproduktet e bujqësisë e industrisë);
- Të shpjegojë rëndësinë ekonomike të pemëtarisë për ekonominë e vendit;
- Të përshkruajë zonat fitoklimatike të pemëve frutore në Shqipëri dhe përfaqësuesit kryesorë për çdo zonë;
- Të klasifikojë pemët frutore sipas organeve frutifikuese, zhvillimit të organeve vegjetative dhe kërkesave për faktorët klimatik;
- Të listojë organet vegjetative dhe frutore të pemëve frutore, hardhi, ulli, agrume;
- Të përshkruajë karakteristikat morfologjike dhe funksionale të pemëve frutore (rrënja-sythi, degët, degëzat, gjethja, lulja, fruti, fara);
- Të përshkruajë fenofazat e ciklit vjetor të një peme frutore;
- Të përshkruajë prodhimin e këmbyer (periodik) dhe ndikimin e tij në prodhimin e pemës;
- Të përshkruajë ndikimin e faktorëve klimatikë dhe tokësorë mbi ecurinë e vegjetacionit dhe

prodhimtarisë së pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve;

- Të përshkruajë mënyrat e shtimit të pemëve frutore, hardhi, ulli agrume;
- Të përshkruajë karakteristikat botanike dhe morfo-biologjike të kulturave frutore më të rëndësishme (farore, bërthamore, arrore, manore, subtropikale dhe hardhisë);

Bazat e blegtorisë

- Të përshkruajë llojet e kafshëve të fermës dhe rëndësinë e tyre sipas drejtimit të prodhimit;
- Të përshkruajë rëndësinë e rritjes së krimbit të mëndafshit, peshkut, bletëve dhe kërmillit;
- Të përshkruajë veçoritë biologjike dhe karakteristikat prodhuese të gjedhit, të imtave dhe të derrit;
- Të listojë racat më të përshtatshme të kafshëve të fermës në përputhje me drejtimin e prodhimit dhe kushteve të fermës;
- Të përshkruajë veçoritë e rritjes dhe prodhimit së shpendëve për prodhim mishi dhe vezësh;
- Të përshkruajë kushtet e rritjes dhe të kultivimit të bletëve, peshqve, kërmillit, krimbit të mëndafshit, etj.;
- Të përshkruajë rëndësinë e përzgjedhjes së llojit të peshqve apo bletëve në përputhje me kushtet për kultivim;
- Të përshkruajë mënyrat e riprodhimit të kafshëve dhe shpendëve me interes ekonomik;
- Të përshkruajë mënyrat e riprodhimit të peshqve, krimbit të mëndafshit dhe kërmijve.
- Të përshkruajë shenjat e maturimit seksuale si dhe të përcaktojë moshën dhe peshën e përshtatshme të riprodhimit në të gjitha llojet e kafshëve të fermës dhe peshqve;
- Të përshkruajë mënyrat e shtimit të bletëve;
- Të tregojë rëndësinë e mirëmbajtjes së kosheres dhe kornizave;
- Të përshkruajë fazat e maturimit të mjaltit për përcaktimin e kohës së vjeljes së tij;
- Të përshkruajë shenjat e pjelljes dhe mënyrat e përkujdesjes për nënën dhe të porsalindurin;
- Të listojë ndërhyrjet e thjeshta të kafshët e fermës (prerja e thundrave, brirëve, etj.);
- Të rendisë tipet e ndryshme të pirëseve të ujit për kafshët e fermës;
- Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e ruajtjes së ushqimit të blegtorisë;
- Të klasifikojë ushqimet bazë që përdoren për kafshët e fermës;
- Të përshkruajë gjendjen fizike të ushqimeve që përdoren në të ushqyerit e kafshëve;
- Të klasifikojë ushqimet sipas cilësisë, sasisë dhe mënyrës së dhënies së tyre;
- Të përshkruajë mënyrat e mjeljes manuale dhe mekanike;
- Të përshkruajë treguesit bazë të një stalle për kafshët e fermës;
- Të listojë kushtet klimaterike të nevojshme për mbarështimin e kafshëve, shpendëve, bletëve dhe peshqve për të siguruar mirëqenien e kafshëve.

Shëndeti i kafshëve dhe kujdesi ndaj tyre

- Të përshkruajë parametrat fiziologjike bazë në kafshët e fermës, shpendët, peshqit dhe bletët;
- Të përshkruajë konceptin e sëmundjes në kafshë, shpendë, peshq dhe bletë;
- Të përshkruajë faktorët që kufizojnë përhapjen e sëmundjes;
- Të listojë mjetet që përdoren në kufizimin e përhapjes së sëmundjes;
- Të shpjegojë konceptin e karantinës;
- Të listojë mjetet për pastrimin dhe mjekimin e plagëve të thjeshta.
- Të përshkruajë etapat e pastrimit dhe mjekimit të plagëve të thjeshta;
- Të përshkruajë masat profilaktike të tilla si: dezinfektimi i stallës, parkut të bletëve apo fermës së peshqve dhe territorit përreth;
- Të përshkruajë metodat e fiksimit në kafshë të ndryshme;

- Të përshkruajë shenjat e sëmundjeve më të shpeshta në kafshë, shpendëve, bletëve dhe peshqve;
- Të rendisë disa nga përkujdesjet e veçanta që kërkojnë kafshët përpara lindjes;
- Të listojë disa nga përkujdesjet e veçanta që kërkojnë peshqit në fazat e ndryshme të rritjes së tyre.
- Të rendisë disa nga përkujdesjet e veçanta që kërkojnë bletët në fazën e shumimit të tyre.
- Të përshkruajë shenjat në pjelljet e vështira;
- Të listojë masat për lindjet e vështira në kafshë;
- Të përshkruajë elementet bazë të higjienës së ambientit të brendshëm dhe të jashtëm të stallës;
- Të përshkruajë elementet bazë të higjienës së kafshës;
- Të përshkruajë elementet bazë të higjienës të enëve të qumështit, të qumështit dhe të produkteve blegtorale;
- Të përshkruajë parametrat e higjienës në parqet e bletëve;
- Të përshkruajë parametrat e higjienës në fermat me peshq, krimba mëndafshi dhe kërmij.

Përpunime të thjeshta të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale

- Të përshkruajë rëndësinë dhe rregullat e higjienizimit të vendit dhe mjeteve të punës;
- Të listojë llojet e materialeve për dezinfektimin e vendit dhe mjeteve të punës si dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë mjetet kryesore të punës që nevojiten në procesin e përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Të argumentojë rëndësinë e përzgjedhjes së produkteve bujqësore dhe blegtorale sipas kërkesave të përpunimit;
- Të përshkruajë rëndësinë e higjienizimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale si dhe mjetet/materialet përkatëse;
- Të përshkruajë llojet e lëndëve ndihmëse dhe rolin e tyre në ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Të përshkruajë llojet dhe mënyrat kryesore të përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale (tharje, ngrirje, pasterizim, sterilizimi, konservim me mjete kimike natyrore dhe artificiale, zierje, pjekje, regjie);
- Të përshkruajë teknikat dhe metodat tradicionale të përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Të listojë llojet e ambalazheve dhe përdorimet e tyre në produktet e përpunuara bujqësore dhe blegtorale;
- Të listojë mënyrat e ambalazhimit dhe etiketimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale të përpunuara;
- Të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes dhe magazinimit të produkteve të përpunuara sipas parametrave teknik të kërkuara;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e përpunim të mbetjeve nga produktet bujqësore dhe blegtorale;
- Të përshkruajë rëndësinë e gjurmueshmërisë në prodhimin e produkteve, për garantimin e sigurisë ushqimore.

Mjete dhe pajisje manuale dhe të mekanizuara në ferma bujqësore dhe blegtorale

- Të përshkruajë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuar) për punimin e tokës dhe përdorimet e tyre;
- Të rendisë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuar) për plehërimin e tokës

- dhe përdorimet e tyre;
- Të listojë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuar) për mbjelljen e farave dhe fidanëve dhe përdorimet e tyre;
- Të listojë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuar) për kullimin e tokës dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuar) për ujitjen e kulturave bujqësore dhe përdorimet e tyre;
- Të rendisë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuar) për shërbime agroteknike të kulturave bujqësore dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuar) për vjeljen, korrijen dhe mbledhjen e kulturave bujqësore dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuar) për mjeljen e kafshëve dhe përdorimet e tyre;
- Të listojë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuar) për transport të produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e mjeteve të thjeshta të punës në bujqësi;
- Të përshkruajë mënyrat e pastrimit dhe dezinfektimit të mjetet dhe pajisjeve;
- Të rendisë mënyrat e mirëmbajtjes së pajisjeve të thjeshta manuale ose të mekanizuara;
- Të listojë mjetet që përdoren në riprodhimin të peshqve, krimbave të mëndafshit dhe kërmijve;
- Të përshkruajë mjetet që përdoren për vjeljen e mjaltit dhe shtimin e bletëve.

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të higjienës personale;
- Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të parimeve të etikës profesionale;
- Të shpjegojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të shpjegojë parimet e punës në grup;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e koordinimit të veprimtarive me kolegët dhe eprorët;
- Të përshkruajë rëndësinë e raportimeve në mënyrë profesionale;
- Të tregojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK);

Sigurimi teknik e mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë;
- Të listojë mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes personale dhe kolektive në punë;
- Të listojë aksidentet kryesore që mund të ndodhin gjatë punimeve të ndryshme në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë dhe mënyrën e shmangies së tyre;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të rregulloreve përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike të rrezikshme;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregulloreve përkatëse gjatë përdorimit të materialeve të ndezshme dhe bombolave të gazit;
- Të shpjegojë nevojën e zbatimit të manualeve përkatëse në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të përshkruajë rregullat e ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të tregojë rëndësinë e respektimit të sinjalistikën (udhëzimet e shkruara) dhe protokollet e

- evakuimit në raste emergjence në mjediset e punës;
- Të përshkruajë rregullat që përdoren gjatë manipulimit në feramat blegtorale;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së ambientit dhe masat përkatëse për eliminimin e ndotjes gjatë proceseve të punës në bujqësi dhe blegtori;
- Të përshkruajë domosdoshmërinë e ndarjes së mbeturinave sipas llojit të tyre;

Rezultatet e të nxënit në:

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin mësimor “Bujqësi” niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, individi do të përvetësojë aftësitë profesionale të mëposhtme:

Bazat e bujqësisë

- Të dallojë Ekosistemin nga Agroekosistemi;
- Të identifikojë zonat dhe nënzonat klimatike të vendit tonë dhe bimësinë përkatëse e tyre;
- Të dallojë bimët bujqësore;
- Të identifikojë pjesët përbërëse të bimëve;
- Të dallojë fazat përkatëse të bimëve;
- Të kryejë shumëzimin me farë dhe shtimin në mënyrë vegetative të bimëve bujqësore;
- Të zbatojë masat mbrojtëse kundër erozionit të tokës;
- Të zbatojë masat që reduktojnë përmytjet;
- Të dallojë qarkullimin bujqësor nga bashkëshoqërimi;
- Të identifikojë barërat e këqija;
- Të dallojë bimët e prekura nga sëmundjet dhe dëmtuesit;
- Të zbatojë Praktikat e Mira Bujqësore;
- Të dallojë hidrometeorët kryesorë;
- Të përdorë instrumentet e zbulimit të përfshira të një qendër meteorologjike si: termometri, higrometri/barometri, matësi i shiut dhe pluviografi, anemometri, anemoskopi, piranografi, heliofanografi, avullometri;

Organizimi i punës dhe përgatitja e vendit të punës për kryerjen e aktiviteteve bujqësore dhe blegtorale

- Të ndihmojë në organizimin e vendit të punës për kryerjen e proceseve të punës në bujqësi dhe blegtori;
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për proceset e ndryshme të punës në bujqësi dhe blegtori;
- Të organizojë dhe vendosë mjetet, pajisjet dhe materialet për procese të ndryshme pune në mënyrë sa më të përshtatshme;
- Të respektojë rregulloret e higjienës personale në punë;
- Të kryejë mirëmbajtjen dhe higjienizimin e veglave, pajisjeve dhe materialeve të punës;
- Të sistemojë vendin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës pas çdo procesi të punës;

Përgatitja e tokës për mbjellje

- Të dallojë llojet e relievit dhe përshtatshmërinë e tyre për kultivimin e kulturave bujqësore;
- Të përshtatë kulturën bujqësore sipas tipit të tokës;
- Të kryejë proceset e parapërgatitjes së tokës për mbjellje;
- Të kryejë pastrimin e tokës nga materialet e ngurta ose mbetjet bimore;
- Të marrë pjesë në ngritjen e sistemit të kullimit dhe drenazhimit;

- Të ndërtojë brezat mbrojtës të parcelave sipas funksionit të tyre;
- Të punojë tokën sipas agroteknikës së kulturave bujqësore;
- Të marrë mostra të tokës dhe ta përgatitë për analizim;
- Të kryejë plehërimin organik të tokës sipas agroteknikës së kulturave bujqësore;
- Të asistojë në ndërtimin e sistemit të ujitjes dhe procesit të ujitjes, sipas agroteknikës së kulturave bujqësore;

Përgatitja e farave e fidanëve dhe mbjellja e tyre

- Të dallojë llojet e farave dhe fidanëve që përdoren në bujqësi;
- Të zbatojë mënyrat e ruajtjes së farave për mbjellje sipas parametrave të përcaktuar;
- Të zbatojë mënyrat e ruajtjes së fidanëve për mbjellje sipas parametrave të përcaktuar;
- Të respektojë afatet më të përshtatshme të mbjelljes së farës dhe fidanëve;
- Të kryejë trajtime të thjeshta profilaktike të farave dhe fidanëve para mbjelljes;
- Të asistojë në ndërtimin e farishteve dhe fidanishteve sipas kulturave, si dhe parametrave kryesore të tyre;
- Të realizojë shtimin e fidanëve sipas teknikave të duhura ;
- Të ndërtojë vllaja (parcelëza) për mbjelljen e farave dhe fidanëve;
- Të ambalazhojë farat dhe fidanët sipas llojit të kulturës bujqësore;
- Të kryejë trajtimet e duhura parapërgatitore të fidanit dhe farës për mbjellje;
- Të zbatojë teknikat e duhura në hapjen e gropave sipas parametrave teknik të kërkuar dhe llojit të kulturës bujqësore;
- Të respektojë distancat, thellësitë dhe teknikat e mbjelljes së farave dhe fidanëve;
- Të kryejë shërbimet e duhura për mbirjen e farave dhe zënien e fidanëve;
- Të kryejë shërbimet e duhura në farishte dhe fidanishte;

Shërbime të kulturave bujqësore

- Të respektojë afatet e duhura për shërbimet kryesore të kulturave bujqësore;
- Të kryejë rrallimin dhe zëvendësimin e fidanëve dhe bimëve duke respektuar dendësinë e nevojshme sipas kulturës bujqësore;
- Të kryejë kultivimin-prashitjen e kulturave bujqësore sipas agroteknikës;
- Të kryejë plehërimin organik të kulturave bujqësore sipas fazave agroteknike;
- Të asistojë gjatë plehërimit plotësues të kulturave bujqësore sipas fazave të zhvillimit të bimëve;
- Të ujisë kulturat bujqësore sipas kërkesave dhe fazave të zhvillimit të tyre;
- Të vendosë sistemin mbështetës të kulturave bujqësore;
- Të kryejë heqjen e sjetullorëve dhe lastarëve të kulturave bujqësore sipas udhëzimeve;
- Të kryejë krasitje të thjeshta të kulturave bujqësore sipas udhëzimeve;
- Të kryejë rrallimin e frutave të kulturave bujqësore sipas udhëzimeve;
- Të kryejë luftimin e barërave të këqija me metoda dhe mjete të thjeshta;

Trajtime të thjeshta profilaktike të kulturave bujqësore

- Të dallojë llojet e plehrave organike sipas rëndësisë së përdorimit të tyre;
- Të dallojë llojet e dezinfektantëve dhe përdorimet e tyre në kulturat bujqësore sipas legjislacionit në fuqi;
- Të monitorojë fazat e zhvillimit të bimëve për të identifikuar praninë/mospraninë e sëmundjeve apo dëmtuesve;
- Të dallojë simptomat e thjeshta e të sinjalizojë specialistet përkatës për sëmundjet dhe dëmtuesit që dallohen me sy të lirë;

- Të përdorë teknikat e thjeshta për luftimin e sëmundjeve;
- Të përdorë teknika të thjeshta për luftimin e dëmtuesve;
- Të kryejë dezinfektimin e drufrutorëve bazuar në praktikat më të mira të punës;
- Të asistojë specialistin gjatë përdorimit të pesticideve ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve;

Vjelja, korrja dhe mbledhja e produkteve bujqësore dhe blegtorale

- Të identifikojë llojet e ndryshme të produkteve që prodhohen në ferma bujqësore dhe blegtorale;
- Të diferencojë fruta, kallinj, perime, etj. në faza të ndryshme të pjekjes së tyre;
- Të kryejë vjeljen, korrjen dhe grumbullimin e produkteve bujqësore në mënyrë manuale ose me mjete dhe pajisje të thjeshta;
- Të vendosë produktet në kontejner për transport në mënyrë pa i dëmtuar ato;
- Të kryejë pastrimin dhe seleksionimin sipas llojit të produkteve të fermës;
- Të kryejë grumbullimin e produkteve me origjinë shtazore duke zbatuar normat e sigurisë ushqimore;
- Të ambalazhojë disa lloje të produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Të kryejë etiketimin e produkteve sipas legjislacionit në fuqi;
- Të ruajë produkteve bujqësore në transport dhe në magazinë sipas parametrave të kërkuara;
- Të dallojë disa nga elementët kryesorë të dëmtuesve të produkteve bujqësore e blegtorale pas vjeljes (myku, brejtësit, kandrrat);

Kulturat bujqësore

- Të asistojë në ngritjen e perimores;
- Të identifikojë lloje të serrave sipas mënyrës së funksionimit;
- Të kryejë kultivimin e drithërave, sipas udhëzimeve të specialistëve;
- Të kryejë kultivimin e bimëve zbukuruese dhe luleve sipas udhëzimeve të specialistëve;
- Të kryejë kultivimin e bimëve bishtajore për kokërr sipas udhëzimeve të specialistëve;
- Të kryejë kultivimin e bimëve industriale sipas udhëzimeve të specialistëve;
- Të kultivojë bimët etero-vajore sipas udhëzimeve të specialistëve;
- Të kultivojë kulturave foragjere sipas udhëzimeve të specialistëve;
- Të kultivojë pemët drufrutorë, hardhitë, ullinj të dhe agrumet, sipas udhëzimeve të specialistëve;
- Të dallojë organet vegjetative dhe frutore të pemëve frutore, hardhi, ulli, agrume;
- Të dallojë pjesët përbërëse të bimëve (rrënja-sythy, degët, degëzat, gjethja, lulja, fruti, fara);
- Të dallojë fenofazat e ciklit vjetor të një pemë frutore, hardhie, ulliri dhe agrume;
- Të kryejë shtimin e pemëve frutore, hardhi, ulli agrume;

Bazat e blegtorisë

- Të dallojë kafshët e fermës sipas drejtimit të prodhimit;
- Të dallojë karakteristikat prodhuese të gjedhit, të imtave dhe derrit;
- Të përzgjedhë racat më të përshtatshme të kafshëve të fermës në përputhje me drejtimin e prodhimit dhe kushteve të fermës;
- Të dallojë karakteristikat prodhuese të shpendëve për prodhim mishi dhe vezësh;
- Të dallojë karakteristikat e kultivimit të bletëve, peshqve, kërmillit, krimbit të mëndafshit, etj. në përputhje me kushte për kultivim;
- Të asistojë në mënyrat e riprodhimit të kafshëve dhe shpendëve me interes ekonomik;
- Të asistojë në mbarështimin e krimbit të mëndafshit, peshkut, bletëve dhe kërmillit;
- Të dallojë shenjat e maturimit seksuale dhe të përcaktojë moshën dhe peshën e përshtatshme

- për riprodhim në të gjitha llojet e kafshëve të fermës dhe peshqve;
- Të asistojë në shtimin e bletëve;
- Të mbajë në gjendje të mirë mjetet bazë të bletarisë;
- Të dallojë kohën për vjeljen e mjaltit;
- Të dallojë shenjat e pjelljes
- Të përkujdeset për nënën dhe të porsalindurin;
- Të asistojë specialistin në ndërhyrjet e thjeshta të kafshët e fermës;
- Të mirëmbajë pirëset e ndryshme të ujit për kafshët e fermës;
- Të respektojë mënyrat dhe teknikat e duhura të ruajtjes së ushqimit të blegtorisë;
- Të dallojë gjendjen fizike dhe cilësinë e ushqimeve që përdoren në të ushqyerit e kafshëve;
- Të përzgjedhë ushqimet bazë që përdoren për kafshët e fermës;
- Të kryejë mënyrat e mjeljes manuale dhe mekanike;
- Të monitorojë kushtet klimaterike të nevojshme për mbarështimin e kafshëve, shpendëve, bletëve dhe peshqve për të siguruar mirëqenien e kafshëve.

Shëndeti i kafshëve dhe kujdesi ndaj tyre

- Të dallojë parametrat fiziologjike bazë të kafshët e fermës, shpendët, peshqit dhe bletët;
- Të dallojë kafshët, shpendët, peshqit dhe bletët e sëmura;
- Të respektojë masat që kufizojnë përhapjen e sëmundjes;
- Të përdorë mjetet për kufizimin e përhapjes së sëmundjes;
- Të zbatojë procedurat e karantinës;
- Të pastrojë dhe mjekojë plagët e thjeshta në kafshët e fermave.
- Të zbatojë masat profilaktike të tilla si: dezinfektimi i stallës, parkut të bletëve apo fermës së peshqve dhe territorit përreth;
- Të kryejë fiksimin në kafshë të ndryshme në fermë;
- Të dallojë shenjat e sëmundjeve më të shpeshta në kafshë, shpendë, bletë dhe peshq;
- Të përkujdeset për kafshët përpara lindjes;
- Të përkujdeset për peshqit në fazat e ndryshme të rritjes së tyre.
- Të përkujdeset për bletët në fazën e shumimit të tyre.
- Të asistojë në pjelljet e vështira;
- Të zbatojë rregullat e higjienës së ambientit të brendshëm dhe të jashtëm të stallës;
- Të zbatojë rregullat e higjienës së kafshës;
- Të zbatojë rregullat e higjienës të enëve të qumështit, të qumështit dhe të produkteve blegtorale;
- Të respektojë parametrat e higjienës në parqet e bletëve;
- Të respektojë parametrat e higjienës në fermat me peshq, krimba mëndafshi dhe kërmij.

Mjete dhe pajisje manuale dhe të mekanizuara në ferma bujqësore dhe blegtorale

- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuara) për punimet e tokës;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuara) për plehërimin e tokës;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuara) për mbjelljen e farave dhe fidanëve;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuara) për kullimin e tokës;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuara) për ujitjen e kulturave bujqësore;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuara) për shërbimet agroteknike të kulturave bujqësore;

- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuara) për vjeljen, korrijen dhe mbledhjen e kulturave bujqësore;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuara) për mjeljen e kafshëve;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e thjeshta (manuale ose të mekanizuara) për transport të produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Të kryejë riparime të thjeshta të mjeteve dhe pajisjeve të punës në bujqësi;
- Të kryejë pastrimin dhe dezinfektimin e mjeteve dhe pajisjeve;
- Të mirëmbajë pajisje të thjeshta manuale ose të mekanizuara;
- Të përdorë mjete dhe pajisje për riprodhimin e peshqve, krimbave të mëndafshit dhe kërmijve;
- Të përdorë mjete dhe pajisje për vjeljen e mjaltit dhe shtimin e bletëve.

Përpunime të thjeshta të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale

- Të realizojë higjienizimin e vendit dhe mjeteve të punës;
- Të asistojë në dezinfektimin e vendit dhe mjeteve të punës;
- Të përdorë mjetet kryesore të punës në procesin e përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Të përzgjedhë produktet bujqësore dhe blegtorale sipas kërkesave të përpunimit;
- Të kryejë higjienizimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale duke përdorur mjetet/materialët përkatëse;
- Të përdorë llojet të ndryshme të lëndëve ndihmëse për ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Të demonstrojë llojet dhe mënyrat kryesore të përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale (tharje, zierje, pjekje, regjie.);
- Të përpunojë produkte bujqësore dhe blegtorale duke përdorur teknikat dhe metodat tradicionale;
- Të kryejë ambalazhimin dhe etiketimin e disa produkte të përpunuara bujqësore dhe blegtorale;
- Të vendosë në magazinë për ruajtje produktet e përpunuara sipas parametrave teknik të kërkuara;
- Të kryejë përpunimin e mbetjeve nga produktet bujqësore dhe blegtorale;
- Të demonstrojë një model të gjurmueshmërisë në prodhimin e produkteve, për garantimin e sigurisë ushqimore.

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të zbatojë parimet e etikës profesionale;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të komunikojë me profesionalizëm me kolegë dhe eprorë;
- Të koordinojë veprimtarinë me kolegët dhe eprorët;
- Të respektojë parimet e punës në grup;
- Të përdorë terminologjinë teknike të profesionit;
- Të respektojë komunikimin sipas hierarkisë;
- Të demonstrojë aftësi në përdorimin e TIK në komunikimin;

Sigurimi teknik e mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve në bujqësi dhe blegtori;
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti;

- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit;
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes ndaj zjarrit në vendin e punës;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes individuale dhe kolektive në vendin e punës;
- Të marrë masat e duhura për parandalimin e ndotjes së ambientit në vendin e punës;
- Të respektojë rregulloret përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike të rrezikshme;
- Të zbatojë rregulloret përkatëse gjatë përdorimit të materialeve të ndezshme dhe bombolave të gazit;
- Të zbatojë manualet përkatëse në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të zbatojë rregullat e duhura gjatë manipulimit në feramat blegtorale;
- Të respektojë sinjalistikën (udhëzimet e shkruara) dhe protokollat e evakuimit në raste emergjence në mjediset e punës;
- Të zbatojë rregullat për ruajtjen e mjedisit;
- Të zbatojë procedurat e duhura për eliminimin e ndotjes gjatë proceseve të punës në bujqësi dhe blegtori;
- Të ndajë mbetjet sipas llojit;

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integrimeve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.